



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal

Ministarstvo Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 10.11.2020 Nr.020-828
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

Inderuar Kryetar,
Inderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet baze dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim i Kuvendit të Komunës 12 Nr. 462/01-47381 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme të Komunës për personin fizik Ragip Veseli
I miratuar më datë: 30.10.2020
I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 30.10.2020

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal

Ministarstvo Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government

Za:	Ramiz Lladrovci, gradinačelnik opštine Glogovac Labinot Halilaj, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MLS-a Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MLS-a	
Od:	Venera Ćerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MLS-a	Datum, 10.11.2020 br. 020-828
Odgovorni službenici:		
1. Službenik za utvrđivanje pravne procene	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština,	
2. Službenik-ca za izradu pravne procene	Vjosa Ahmetaj, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Glogovac	
Vrsta akta:	☐ Odluka skupštine opštine	

Uvažani gradonačelnice,

Uvaženi predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, i na osnovu zakonskih ovalčenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 06/2020 o administrativnim oblastima i odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03 / L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka Skupštine opštine 12 br. 462/01-47381 o davanju na dugotrajno korišćenje od devedest i devet (99) godina nepokretnu imovinu opštine fizičkom licu Ragip Veseli
Usvojena dana, 30.10.2020. godine
Dostavljena na razmatranje u MLS-u dana, 30.10.2020. godine

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta, ocenjuje da je opštinski akt u *proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi* i kao takav može proizvesti pravne efekte.

Ministarstvo lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za svako dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

I. SHPREHJA E INTERESIT

Neni 3, paragrafi 1.13 i Ligjit - Shprehja e interesit nënkupton procesin e konkurrencës së hapur ku fituesi zgjidhet në bazë të kriterëve të specifikuar në thirrjen për ofertë.

Neni 13 i Rregullores - Përmes procedurës së shprehjes së interesit mund të jepet prona e paluajtshme e komunës në shfrytëzim afatgjatë prej 15 deri në 99 vite.

Në kuadër të dhënies së prona përmes shprehjes së interesit, komuna duhet të ndjek kushtet si në vijim:

1. Të jetë e regjistruar si pronë e komunës në regjistrat kadastrale të pronës, të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta, të mos ketë ndonjë kontest pronësor (këto informata gjinden në certifikatën e pronësisë);
2. Të jetë në pajtueshmëri me dokumentet e planifikimit hapësinor, të ketë arsyeshmërinë të interesit publik, të ndikojë në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë, të ndikojë në rritjen e vlerës së pronës; (Të gjitha këto kërkesa duhet të arsyetohet në pjesën e arsyetimit të vendimit të kuvendit të komunës);
3. Ndersa, Plani Zhvillimor Komunal si dhe kushtet mjedisore (të vendosen në preambulën e Vendimit);
4. Të jetë publikuar prona në listën e përgjithshme ose të veçantë të pronave që planifikohen të jepen në shfrytëzim, të jetë miratuar nga Kuvendi me vendim paraprak propozimi i Kryetarit për dhënien në shfrytëzim të pronave; (Pas datës 1 janar 2021 në mungesë të dëshmisë për këto dy kërkesa, lënda do të konsiderohet e pakompletuar);

Lëndës duhet ti bashkëngjitet edhe:

- | | |
|------|---|
| I. | Certifikata e pronës; |
| II. | Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës; |
| III. | Vendimi i Kuvendit Komunal për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës; |

VIOSA AHMETAS
XHEVAT TAFA
VENERA ÇERKINI



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
KUVENDI I KOMUNËS

12 Nr. 462/14-5738/dt. 30/10/2020

Ministria e Administratës Lokale Ministry of Local Government Administration State of Local Government Administration	
Data Datum Date	30-10-2020
Numri i dokumentit Nr./Lendës Project Vite	020-823

Bazuar në nenin 11.12.dhe 40.13 Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenin 5, nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenin 19 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.06 L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 13, 14, 22 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës të Komunës, duke vepruar sipas Rekomandimit të Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës 01-Nr.052/03-43188 të datës 09.10.2020.për zgjedhjen e ofertës ekonomike më të favorshme. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.10.2020, miraton këtë:

V E N D I M

Për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës për personin fizik Ragip Veseli

Neni 1

Miratohet Vendimi për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së shprehjes së interesit, personit fizik Ragip Veseli në parcelën kadastrale nr.P-70314035-01979-0, në sipërfaqe të përgjithshme 12111.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fush- Gjer", Zona Kadastrale Komoran, në pronësi të Komunës së Glllogocit.

Neni 2

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës të përshkruar në pikën 1 të këtij vendimi është afatgjatë në periudhën prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është interesi publik dhe përfitimi financiar dhe ekonomik i Komunës së Glllogocit nga prona komunale.

Neni 4

Pas miratimit të vendimit përfundimtar nga ana e Kuvendit të Komunës, autorizohet Kryetari i Komunës që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit të lidhë kontratë me fituesin.

Neni 5

Kontrata për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës nënshkruhet nga kryetari i komunës i cili përfaqëson komunën dhe nga fituesi i përzgjedhur, me anë të së cilës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

Neni 6

Prona e paluajtshme që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën I të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastrale të Komunës.

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 8

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Certifikata e pronësisë dhe kopja e planit.

Neni 9

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga data regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Udhëfaqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit.



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA DRENAS
SKUPSTINA OPSTINE

Br. 12-462/01 - 47381, dt. 30.10.2020

Na osnovu clana 11, 12 i 40. Zakona Br. 03/L-040, o Lokalnoj Samoupravi, clan 5, clan 6 stav 1 podstav 1.2, clan 8 stav 1 podstav 1.2, clan 19 stav 3 podstav 3.1 Zakona Br. 06/L-092 za koriscenje i zamenu nepokretne opstinske imovine, clan 13, 14, 22 Uredbe (URC) Br. 09/2020, o odredivanju postupka za za odobravanje n.koriscenje i zamenu nepokretne opstinske imovine postupajuci prema preporukama komisije za ocenu o sprovođenju postupka za odobravanje o koriscenju nepokretne opstinske imovine br.01-Nr.052/03-43188, datuma 09.10.2020 za izbor najpovoljnije ekonomske ponude. Skupstina Opstine na sednici održanoj datuma 30.10.2020. Odobrava ovu :

ODLUKU

Za dugoročno koriscenje od devedeset i devet (99) godina nepokretne opstinske imovine za fizičko lice Ragip Veseli

Clan 1

Odobrava se resenje za dugoročno koriscenje od devedeset i devet (99) godina nepokretne opstinske imovine postupkom iskazivanja interesa fizičkog lica Ragip Veseli ukatastarskoj parceli br.P-70314035-01979-0, ukupne površine od 12111.0 m², koja se nalazi na takozvanom mestu "Fush- Gjer", Katastarska Zona Komorane, u vlasnistvu opstine Glogovac.

Clan 2

Rok za dugoročnu upotrebu nepokretne opstinske imovine opisan u tacki 1 ove odluke je dugoročan u period od devedeset i devet (99) godina.

Clan 3

Svrha o davanju na koriscenje nepokretne opstinske imovine je javni interes finansijska i ekonomska korist opstine Glogovac iz opstinske imovine.

Clan 4

Nakon odobrenja konačne odluke od strane Skupstine Opstine, Predsednik Opstine ovlašćen je da zaključi ugovor sa pobednikom u roku od 10 radnih dana od stupanja na snagu odluke.

Clan 5

Ugovor o davanju na dugoročno koriscenje nepokretne opstinske imovine potpisuje Predsednik Opstine koji predstavlja opstinu i izabrani pobednik putem kojeg se utvrđuju prava i obaveze ugovornih strana.

Clan 6

Nepokretna imovina data na koriscenje opisana u tacki 1 ove odluke mora biti upisana u katastarske knjige opstine.

Clan 7

Za sprovođenje ove odluke brinice se : Predsednik Opštine, Direkcija za Geodeziju , Katastar i Imovina, Direkcija za Budžet i Finansije.

Clan 8

Sastavni deo ove odluke su: Kopija Plana i Uverenje katastarskih celina .

Clan 9

Ova odluka stupa na snagu 15 dana od dana registracije i procene zakonosti od strane MLU-ve i 7 dana nakon objavljivanja na zvaničnoj Ueb stranici opštine

Odluka dostavlja se :

- Kancelariji Predsednika
- Nadležnoj Direkciji :
- Kancelariji Skupštine:
- Arhivi




Predsedavajući Skupštine Opštine

Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Zyra e Kryetarit
01-Nr. 462/01-46246 dt. 26/10 2020



Në mbështetje të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 5, nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenin 19 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 13, 14, 22 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës të Komunës, duke vepruar sipas Rekomandimit të Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës 01-Nr.052/03-43188 të datës 09.10.2020 për zgjedhjen e ofertës ekonomike më të favorshme. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë _____ të miratojë këtë:


PROPOZIM VENDIM

Për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës

- I. Miratohet Vendimi për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së shprehjes së interesit, personit fizik Ragip Veseli në parcelën kadastrale nr.P-70314035-01979-0, në sipërfaqe të përgjithshme 12111.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fush- Gjer", Zona Kadastrale Komoran, në pronësi të Komunës së Glllogocit.
- II. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës të përshkruar në pikën 1 të këtij vendimi është afatgjatë në periudhën prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është interesi publik dhe përfitimi financiar dhe ekonomik i Komunës së Glllogocit nga prona komunale.
- IV Pas miratimit të vendimit përfundimtar nga ana e Kuvendit të Komunës, autorizohet Kryetari i Komunës që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit të lidhë kontratë me fituesin.
- V. Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës nënshkruhet nga kryetari i komunës i cili përfaqëson komunën dhe nga fituesi i përzgjedhur, me anë të së cilës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
- V. Prona e paluajtshme që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën I të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastrale të Komunës.
- VI. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- VII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Certifikata e pronësisë dhe kopja e planit.

R. Q.

VIII. Ky vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës, dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Pushtetit Lokal.



ARSYETIM

Bazuar në Njoftimin Publik 01-Nr.462/01-38720 dt. 16.09.2020, pas hapjes së ofertave me datë 02.10.2020, ora 09:00, dhe vlerësimit të ofertave me datë 05, 06, 07, 08 tetor 2020, nga ana e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Me datë 09.10.2020, ora 08:00 në mbledhjen e mbajtur, anëtarët e komisionit, kanë shqyrtuar, dhe vendosur të propozojnë fituesit për parcelat kadastrale sipas Njoftimit Publik 01-Nr.462/01-38720 dt. 16.09.2020, në ofertat e paraqitura nga ofertuesit sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, siç janë të përcaktuara Kriteret për zgjedhjen e ofertave nëni 1 paragrafi 1. Zgjedhja e ofertës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret vijuese: 1.1 Oferta ekonomike më e favorshme që përfshinë: 1.1.1 Vlera e investimit, 1.1.2 Numri i të punësuarve nga investimi; 1.1.3 Lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën, 1.1.4 Përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës; 1.1.5 Kriteret e tjera të cilat mund të përcaktohen me konkurs.

Dhe në bazë të Raportit të Vlerësimit të Ofertave 01-Nr.052/03-43188 dt.09.10.2020, në Konkurrimin publik për dhënie e pronave të paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite, dhe Rekomandimit të Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës 01-Nr.052/03-43188 të datës 09.10.2020, për përzgjedhjen e fituesit, i dërgohet Kuvendit të Komunës për miratim Propozim Vendimi Për Dhënie në Shfrytëzim Afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office : GLOGOC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Komoran

Njësia Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70314035-01979-0	Parcelë / Parcela / Parcel	12111



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1167

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date 20.03.2020

Koha/ Vreme/ Time 09:29:25

Nënshkrimi/Potpis/Signature

Shënim/Baleška/Note



Approv./Usmici/Approved

Qrejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - E Kuda - Government

MINISTRIA E KRONOMISË DHE AMBIESE, MINISTERTYO EKONOMIAJE I ZEVËTNE SHËRME, MINISTRI OF ECONOMY AND FINANCE
AGENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / AGENCY OF CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70314035-01979-0

Numeri i referencës / Broj Referent Number: Data dhe koha e dorëzimit / Datum i vremen izdavanja / Date and time of submission: Komuna / Opština Municipality: Zona kadastrale / kadastrarska Zona / Cadastrel Zone: Zyra kadastrale komune / Opštinska kadastrarska kancelarija / Municipal Cadastrel Office: Glogovac / Glogovac / Glogovac	07-04-1808-2020 20.08.2020 - 09:35 Glogovac / Glogovac / Glogovac KOMITRAN / KOMITRANI / KAMARAN
---	---

A.TË DHËNJAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numeri i njësive kadastrale Broj kadastrarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësive Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i prorisë Vrsta imovine Property Type	Zona UTR GIS UTR	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Prekthetimi Opis Description	Kerthuar me daten i prodhimit Created On	Aktivuar Aktivirano I published
P-70314035-01979-0	PARCELE / PARCELA / PARCELA	Imovine / Imovina / Socially owned Land	Rural	12111	SHTRAS KURTESH-SH. TERBENI 07 943 8 85 306 131 01 09 2019	17.05.2020	20.08.2020

A.I ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresë Postblloku - adresa Resident - address	Kodi Postel Postanski kod Postal Code	Hedhëdhë e adresës Pobjednost adresa Address Details	Krijuar me datën Uradnjeno na Created On	Aktivuar Aktivirano Updated
11 SHALLER 11 SHALLER		11 SHALLER	17.05.2020	20.08.2020



Shkurti P-70314035-01979-0

Sigrua frogia (000')

Norma / Reg. Number	1. Tipo e soggetto della pratica 2. Visto ministeriale 3. Partic. Tipo dell'uso	2. Subordinazione e processo 3. Esito della pratica 4. Partic. e valore dell'uso	3. Indicare la qualità della quantità di uso	4. Visto (art.)
1	10 - Notazione (o altro) con funzione limit.	1. Indicazione e valore		12111

Pieces & samples

B. PROVAIR/POSEDERESI - VI/ASNIK/DEZ/ALAC - OVNER/POSSESSOR								
Identificati Prima Inchis	Pont Line Name	No. personal Ticket ID. No.	Venditori Prezident Resident	Scoti postal Postanski kod Postal code	Indicatie e adresesi Popisani Address details	Vicini e jurnesi Decim Share quota	Perishant (Dps) Description	Vizitanti Vizitanti 1-jedini
Prova Indicati Prima Inchis	Prova Indicati Prima Inchis	123456789	ROMANIA KALININ KALININ		123456789	1/1		19.08.2010



9/10/24

Nr. 01/462/01-38720

Për: Komisioni vlerësues të tenderit për Shërbimin e Ankësuar dhe Felisë Për Felinë të Komisionit të Tenderit të Komisionit të Tenderit.

Nga: "K.M." Sh.p.k. me numër matricë identifikuese 80180187, sipas të Pr. Titina Pashën, të kësaj përshkrimi të punës dhe përfaqësuesi i Avokatit Taulant Hoda, me seli në Pr. Felinë të Komisionit të Tenderit, kësaj referencës "Ankuesi".

Datë: Prill 2020;

Kësaj referencës të Komisionit të Tenderit Nr. 01/462/01-38720 Për Shërbimin dhe Komisionin e Pronës të Komisionit të Tenderit dhe në bazë të nenit 125 të Ligjit Nr. 05 L. 031 Për Procedurën e Administrative brenda afatit kohor parashikuar kështu:

ANKESË

kundër

Njoftimit me numër nr. Nr. 01/462/01-38720, të datës 09/10/2020 të Komisionit vlerësues të ofertave për dhënie të pronës së pajmëtsime të Komunitetit, pranuar nga ankuesi me datë: 12/10/2020

Për shkak:

- të shkeljes së dispozitave të procedurës Administrative;
- të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike;
- të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Hyrje

1. Komuna e Glogocit me datë 16.09.2020, ka shpallur Njoftim për Konkurs (ankand) Publik me numër Nr. 01/462/01-38720 për Dhënie e Pronës së Paluajtshme të Komunës së Skenderajt në shfrytëzim afatë gjatë për nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

Provë Nr.1 : Njoftimi për Konkurs (ankand) Publik i datës 16.09.2020:

2. Lëndë e këtij Konkursi ka qenë dhënia e pronës në shfrytëzim për nëntëdhjetë e nëntë vite me qëllim që parcelat e poshtëshënuara janë të destinuara për biznes-zona industriale me plan zhvillimor të Komunës së Glogocit.
3. Konkursi Publik i lartëcekur ka përfshirë parcelat si në vijim:
 - Parcela Kadastrale nr. P-70315016-01016-1, në sipërfaqe të përgjithshme prej 17733.90 m², që gjendet në vendin e quajtur "Balta-Balta" Zona Kadastrale Glogocit.
 - Parcela Kadastrale nr. P-70314035-000202-1, në sipërfaqe të përgjithshme prej 3710.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fshat - Fshat" Zona Kadastrale Komoran.
 - Parcela Kadastrale nr. P-70314035-01980-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2003.0 m², që gjendet në vendin e quajtur, "Fush Gjer" Zona Kadastrale Komoran.
 - Parcela Kadastrale nr. P-70314035-01979-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 12111.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fush Gjer" Zona Kadastrale Komoran.
 - Parcela Kadastrale nr. P-70314035-01981-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 3263.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fush Gjer" Zona Kadastrale Komoran.
 - Parcela Kadastrale nr. P-70310058-02652-2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 3746.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Ara të Zabeli" Zona Kadastrale Arilat.
 - Parcela Kadastrale nr. P-70315015-00764-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 6863.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Mahalla e Binakve" Zona Kadastrale Gllobar.
4. Në këtë Konkurs Publik janë paraparë kushtet të cilat duhet të përmbushen nga ana e ofruesëve në mënyrë që të njëjtit të shpallen fitues në bazë të konkursit të datës 16.09.2020.
5. Ankuesi së bashku me aplikim ka paraqitur ofertën dhe ku të njëjtes i ka bashkangjitur të gjithë dokumentacion e kërkuar përmes konkursit me numër Nr. 01/462/01-38720. (Shih Projektin dhe Ofertën).
6. Me datë 09.10.2020, Komuna e Glogocit përmes Komisionit vlerësues ka nxjerrë Njoftimin me numër Nr. 01/462/01-38720, me të cilin Njoftim ka shpallur vetëm fituesit ndërsa nuk ka dhënë arsyeim për refuzimin e ofertës të Ankuesit.
7. Ankuesi kishre aplikuar për Parcelën Kadastrale nr. P-70314035-01979-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 12111.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fush Gjer" Zona Kadastrale Komoran, ndërsa për të njëjten parcelë është shpallur fitues Ragip Veseli.

8. Në takimën e datës 16 tetor 2020, jemi informuar nga Komisioni i vlerësues se arsyet e mos-përzgjedhjes së Kompanisë ABI janë që në aplikacionin e tij i mungojnë këto të dhëna: përfundimi financiar, projekti ideor, pasqyrat financiare, qarkullim në 5 vitet e fundit dhe letër përkrashja.
9. Në momentin që kemi pasur qasje në ofertën e fituesit, kemi vërejt se në aplikacionin e tij i njëjti nuk pasur fare ofertë, nuk ka pasur pasqyra financiare dhe as qarkullim në 5 vitet e fundit, po ashtu edhe pse është kërkuar garancion bankar aty është një deklaratë e një kompanie sigurimi që nuk është garancion bankar.

Provë: Mënyra e Vlerësimit të Komisionit Vlerësues të datës 09.10.2020;

10. Njoftimi publik i datës 14.09.2020, njoftimi për vlerësimin e ofertave i datës 09.10.2020, si dhe dokumenti i Vlerësimit i datës 09.10.2020 konsistojnë në shkelje të dispozitave të procedurës Administrative, të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të drejtës materiale përkatësisht dispozitave të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

f. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

1. Komisioni vlerësues ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për shkak se në bazë të Konkursit të shpallur me datë 16.09.2020, me numër Nr. 01/462/01-38720 janë paraparë kriteret për pjesëmarrje dhe vlerësim në konkurs dhe atë si vijon :
 - Oferta Ekonomikisht më e favorshme
 - Vlera e Investimit
 - Numri i të punësuarëve nga Investimi
 - Lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën
 - Përfundim financiar dhe ekonomik i komunës

Kurse të njëjtit kanë paraparë edhe kriteret se cilat dokumente duhet të paraqiten me rastin e aplikimit siç janë:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe veprimtaria e përshtatshme
- Për personat fizik, certifikatën e nënshtrësi
- Projektin ideor i investimit
- Për personat juridik pasqyrë financiare të audituara dhe qarkullimin bankar në pesë vitet e fundit

- Garanci bankare prej 30% të vlerës së investimit të projektit
- Afat i realizimit të projektit të investimit është 18 muaj.

2. Ankuesi në bazë të kriterëve të konkursit ka aplikuar dhe ka dorëzuar ofertën e datës dhe i ka bashkëgjuhur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në bazë të konkursit. Ankuesi duke parë që përmes njoftimit të datës 09.10.2020 i njëjti nuk është shpallur fitues, ndërsa për parcelën të cilën ka aplikuar është shpallur fitues personi fizik Ragip Veseli.
3. Ankuesi me bindjen që i njëjti i ka plotësuar kriteret e lartëcekura dhe i njëjti padrejtësisht nuk është shpallur fitues, me datë 12 tetor 2020, në përputhje me Njoftimin Publik, i cili parashihet që pjesëmarrësit në këtë proces kanë të drejtë të kenë qasje në dokumentacionet e pronës si dhe të informohen në lidhje me procedurat e shprehjes së interesit, kanë paraqitur kërkesë për qasje në dokumentacionin – ofertën e fituesit për parcelën për të cilën ka aplikuar Ankuesi, sipas konkursit publik të paraqitur me datë 16.09.2020. (Shih Kërkesa për qasje në dokumentacionin e fituesit e datës 13.10.2020).
4. Me datë 16.10.2020 ju është ofruar qasja në dokumentacion dhe aty është vërejtë se: në përputhje me ofertën e ankuesit dhe në vlerësimin e bashkëlidhur të siguar sipas qasjes në dokumentacion, provohet se ankuesi vlerën e investimit e ka më të lartë se fituesi, po ashtu numrin e punëtorëve e ka më të lartë se fituesi dhe i plotëson kërkesat sipas ftesës për ofertë.
5. Komisioni vlerësues me rastin e vendosjes nuk ka vërtetuar gjendjen faktike dhe gjithashtu nuk ka vërtetuar faktin nëse Ankuesi ka plotësuar kriteret e kërkuara me konkursin dhe nëse janë plotësuar kushtet për shpalljen e fituesit dhe gjithashtu konsiderojmë që Ankuesi është person juridik i cili disa vite më radhë është shpallur si tatimpaguesi më i madhë dhe punëdhënësi më i madhë në Republikën e Kosovës.
6. Ankuesi ka pasur vlerën më të madhe të investimeve në mbi 4 milion, ka pasur numrin më të madhë të të punësuarve, përfutimi për komunën ka qenë shumë dimensional duke përfshirë në vlerën e investimit, numrin e punëtorëve, përfutimin publik të komunës, nuk e ka projektin ideor etj.
7. Pasi patëm qasje në dokumentacion e konkursit dhe ofertën e fituesit kemi vërejtur se arsyetimi i komisionit vlerësues është që Ankuesi nuk ka vendosur çmimin tek rubrika e çmimit të aplikacionit, dhe nuk ka paraqitur përfutimin financiar dhe ekonomik të Komunës. Kjo nuk qëndron pasi lehtë në aplikacionin e Ankuesit dhe Projektin e tij shihet qartë se Ankuesi ka vendosur çmimin dhe atë njëjtë sikur Fituesi përkundër që kjo rubrikë ka qenë e paqartë pasi nuk ka detajizu se cili çmim duhet të vendoset, çmimi total i investimit apo çmimi për metër katror. Pra në asnjë mënyrë nuk ka pasur qartësi në rubrikën e çmimit. Ndërsa aplikuesi në ofertën e bashkëlidhur së bashku me aplikacion ka

pasur të specifikuar çmimin e investimit po ashtu edhe në rubrikën e ka pasur të cekur një vlerë. Në projekt në mënyrë të detajuar është elaboruar përfitimin financiar dhe ekonomik të Komunës. Gjithashtu, edhe plani ideor i ankuesit në mënyrë të detajizuar ka qenë pjesë e projektit, përkundër që në vlerësimin e komisionit ky kusht është i evidentuar si i paplotësuar. Po ashtu edhe gjendja e llogarisë bankare ka qenë pjesë e ofertes në formë të CD-se, përkundër që është evidentuar që mungon nga komisioni i vlerësimit.

8. Po ashtu oferta e Fituesit Ragip Veseli nuk i ka përmbushur kërkesat e ofertës për arsye se të njëjtit nuk i dihen pasyrat financiare, nuk i dihet nëse ka pasur qarkullim në 5 vitet e fundit, nuk i dihet prejardhja e parave, e ka numrin më të vogël të të punësuarve, ka investim më të vogël se Ankuesi. Po ashtu në konkurs është kërkuar garancion bankar ndërsa Fituesi ka paraqitë një deklaratë prej një kompanie të sigurimit. Kjo deklaratë nga kompania e sigurimit nuk është e njëjtë dhe nuk ka siguri sikur garancioni bankar, pra nuk i plotëson kërkesat e konkursit publik.

II. Shkelja e dispozitave të procedurës Administrative

1. Duhet të theksohet se Komisioni vlerësues me rastin e nxjerrjes së Njoftimit me numër Nr. 01/462/01-38720, kanë bërë shkelje të dispozitave që rrjedhin nga Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
2. Njoftimi është nxjerrë në kundërshtim me nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që kënij Njoftimi të lartëcekur i mungon forma e paraparë me dispozitat e lartëcekura e të cilat janë të detyrshueshme me rastin e nxjerrjes së një Njoftimi nga një organ administrative.
3. Neni 47 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative thuhet se elementet e detyrueshme të aktit administrativ janë : pjesa hyrëse, pjesa urdhëruese (dispozitiv), pjesa arsyetuese dhe pjesa përfundimtare si dhe këshillat juridike.
4. Njoftimi i nxjerrë nga Komisioni vlerësues është nxjerrë në kundërshtim me nenin 48 për shkak se i njëjti është i mangët dhe nuk ka fare pjesë arsyetuese se për se i'u është refuzuar oferta Ankuesit dhe cilat kushte nuk i ka plotësuar, kurse në anën tjetër i'u është dhënë e drejta e ankesës, mirëpo që njoftimi nuk ka dispozitiv, i cili do të arakohet.
5. Paragrafi 1 i nenit 48 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka paraparë që arsyetimi duhet të përmbajë:
 - Paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;
 - Shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë Njoftimi
 - Shkaqet të cilat kanë qenë [Njoftimtare gjatë vlerësimit të provave
 - Bazën ligjor të Njoftimit dhe arsyen se përse është zbatuar në rastin konkret

- 5. Shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palës
- 6. Në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpejtimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në Njoftim.

Kurse në paragrafin 2 të po të njëjtit nen është paraparë që nëse një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshëm apo i pakuptueshëm është i barabartë me mungesën e tij. Pra Njoftimi i dhënë, nuk përmbanë asnjë arsyetim i vlerësimit të ofertave dhe as shkaqet për refuzim.

- 6. Duke u bazuar në dispozitën e nenit 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe në Njoftimin e nxjerrë nga Komisioni vlerësues, mund të vijmë në përfundim që i njëjti njoftim nuk përmbanë arsyetim mbi faktet Njoftimtare ashtu siç është specifikuar nga gjendja faktike, është i pamjaftueshëm për shkak se nuk ka specifikuar faktet Njoftimtare mbi të cilat është marrë njoftimi, është kundërtshëm për shkak mungon arsyetimi sa i përket pjesës së dispozitivit si dhe nuk është specifikuar se mbi cilën bazë ligjore është nxjerrë ky njoftim. Bazuar në paragrafin 2 të nenit 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative mund të konkludojmë se nga të gjitha mungesat e lartëcekura, ky njoftim nuk përmban fare arsyetim ashtu siç parashihet me nenin 47 të po të njëjtit ligj.

II. Aplikimi i gabueshëm i dispozitave materiale


1. Komisioni vlerësues me rastin e nxjerrjes së Njoftimit në lidhje me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, konkretisht dispozitën e nenit 19 i cili parashihet se si bëhet vlerësim i ofertave e cili nen parashihet "*Komisioni vlerësues, pas pranimit të ofertave e bën vlerësimin e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik. Njoftimin për përvojebjen e ofertave komisioni e publikon në faqen zyrtare të komunës, si dhe të njëjtin ja dërgon palëve të përfshira në proces*".
2. Komisioni vlerësues nuk ka bërë vlerësimin e ofertave në përputhje me nenin 19 ashtu siç u specifikuar më lartë dhe në Njoftimin e nxjerrë në asnjë moment nuk kanë bërë vlerësimin në bazë të kriterëve të përcaktuara me konkursin publik të shpallur nga vetë Komuna e Drenasit dhe të njëjti nuk kanë dhënë asnjë sqarim nëse ankuesi nuk ka përmbushur ndonjërin nga kriteret e njoftimit publik apo nga kriteret e përcaktuara, komisioni ka vlerësuar se fituesi shpallor Ragip Veseli duke mos dhënë asnjë arsyetim më tepër.
3. Vlenë të shikohet se edhe në bazë të planit të biznesit të "Abi", Sh.p.k, i cili është tatimpaguesi më i madhë në Kosovë dhe ka numrin më të madhë të punëtorëve, ka paraparë investim në shumën që tejkalon shumën prej rreth 4.000.000 (katër milion euro) dhe të punësojë për afërsisht rreth 110 të punësuar. Në asnjë rast vlerësojmë që fituesi i shpallur, ka përfituar nën nga kriteret e njoftimit publik në mënyrë më bindëse se Ankuesit. (shih planin e biznesit të Ankuesit dhe formën e vlerësimit të komisionit vlerësues).

4. Për më shumë edhe Njoftimi publik i datës 14.09.2020 është në kundërshtim me dispozitave të Ligjit nr.06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës pasi ka vendosur kritere tjera për persona fizik dhe tjera për persona juridik. Personat fizik nuk kanë pasur për obligim që të paraqesin pasyqrat financiare, gjendjen e llogaritë bankare e që janë dy prova kryesore që vërtetojnë seriozitetin e investimit.

Duke u bazuar në thëniet e lartëcekura, shkeljet e bërë të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, shkeljet e Dispozitave të Ligjit nr. 06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe duke u bazuar në nenin 20 paragrafin 2. Kërkojmë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave që pas shqyrtimit të ankesës së ankuesit të nxjerrë këtë:

VENDIM

- I. APROVOHET ankesa e ankuesit "ABI" Sh.p.k, me numër unik identifikues 80180187, adresë në Rr. Tirana, Prizren, të cilën përmes autorizimit e përfaqëson Avokat Taulant Hodaj, me seli në Rr. Fehmi Agani 79/8, Prishtinë.
- II. ANULOHET Njoftimi i Komisionit vlerësues me numër nr. Nr. 01/462/01-38720, i nxjerrë me datë 09.10.2020 dhe i pranuar nga ankuesi me datë 12.10.2020, SI I KUNDËRLIGJSHËM.
- III. ANULOHET Njoftimi Publik i Komisionit vlerësues, i nxjerrë me datë 14.09.2020, SI I KUNDËRLIGJSHËM.
- IV. MIRATOHET Oferta e Ankuesit e "ABI" Sh.p.k, me numër unik identifikues 80180187, adresë në Rr. Tirana, Prizren, SI E PLOTË DHE E BAZUAR.
- V. PROCEDOHET për plotësim dhe ndryshim Njoftimi Publik i Komisionit vlerësues PËR APROVIM NË KUVENDIN KOMUNAL TË GLLOGOCIT.



Për dhe në emër të "ABI" Sh.p.k

Taulant Hodaj, Avokat

Nr. 01/462/01-38720

Për: Komunitet e Glogocit, Komisionin Për Shqyrtimin e Ankesave, me seli në Rr. Fehmi
Hudrovci" p.n. 13000 Glogoc, Kosovë

Nga: "Abi" Sh.p.k, me numër unik identifikues 80180187, adresë në Rr. Tirana, Prizren, të
cilën përmes autorizimit e përfaqëson Avokat Taulant Hodaj, me seli në Rr. Fehmi
Agani 79/8, Prishtinë (turje referuar si "Ankuesi")

Datë: 16/10/2020;

Në bazë të nenit 20 të Ligjit 06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së
Paluajtshme të Komunitet dhe në bazë të nenit 125 të Ligjit Nr. 05/L -031 Për Procedurën e
Përgjithshme Administrative brenda afatit kohor paraqesim këtë :

ANKESË

kundër

Njoftimit me numër nr. Nr. 01/462/01-38720, të datës 09/10/2020 të Komisionit vlerësues të
ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunitet, pranuar nga ankuesi me datë:
12/10/2020

Për shkak :

- të shkeljes së dispozitave të procedurës Administrative;
- të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike;
- të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Hyrtje

1. Komuna e Glogocit me datë 16.09.2020, ka shpallur Njoftim për Konkurs (ankand) Publik me numër Nr. 01/462/01-38720 për Dhënie e Pronës së Paluajtshme të Komunës së Shkenderbujt në shfrytëzim afatë gjatë për nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

Provë Nr.1 : Njoftimi për Konkurs (ankand) Publik i datës 16.09.2020;

2. Lëndë e këtij Konkursi ka qenë dhënia e pronës në shfrytëzim për nëntëdhjetë e nëntë vite me qëllim që parcelat e poshtëshënuara janë të destinuara për biznes-zona industriale me plan zhvillimor të Komunës së Glogocit.
3. Konkursi Publik i lartëcekur ka përfshirë parcelat si në vijim:
 - Parcela Kadastrale nr. P-70315016-01016-1, në sipërfaqe të përgjithshme prej 17733.90 m², që gjendet në vendin e quajtur "Balta-Balta" Zona Kadastrale Glogocit.
 - Parcela Kadastrale nr. P-70314035-000202-1, në sipërfaqe të përgjithshme prej 3710.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fshat - Fshat" Zona Kadastrale Komoran.
 - Parcela Kadastrale nr. P-70314035-01980-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2003.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fush Gjer" Zona Kadastrale Komoran.
 - Parcela Kadastrale nr. P-70314035-01979-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 12111.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fush Gjer" Zona Kadastrale Komoran.
 - Parcela Kadastrale nr. P-70314035-01981-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 3263.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fush Gjer" Zona Kadastrale Komoran.
 - Parcela Kadastrale nr. P-70310058-02652-2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 3746.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Ara të Zabeli" Zona Kadastrale Arllat.
 - Parcela Kadastrale nr. P-70315015-00764-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 6863.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Mahalla e Binakre" Zona Kadastrale Gllëbar.
4. Në këtë Konkurs Publik janë paraparë kushtet të cilat duhet të përmbushen nga ana e ofruesëve në mënyrë që të njëjtit të shpallen fitues në bazë të konkursit të datës 16.09.2020.
5. Ankuesi së bashku me aplikim ka paraqitur ofertën dhe ku të njëjtes i ka bashkangjitur të gjithë dokumentacion e kërkuar përmes konkursit me numër Nr. 01/462/01-38720. (Shih Projektin dhe Ofertën).
6. Me datë 09.10.2020, Komuna e Glogocit përmes Komisionit vlerësues ka nxjerrë Njoftimin me numër Nr. 01/462/01-38720, me të cilin Njoftim ka shpallur vetëm fituesin ndërsa nuk ka dhënë arsyerim për refuzimin e ofertës të Ankuesit.
7. Ankuesi kishte aplikuar për Parcelën Kadastrale nr. P-70314035-01979-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 12111.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fush Gjer" Zona Kadastrale Komoran, ndërsa për të njëjten parcelë është shapllur fitues Ragip Veseli.

8. Në takimën e datës 16 tetor 2020, jemi informuar nga Komisioni i vlerësues se arsyet e mos-përzgjedhjes së Kompanisë ABI janë që në aplikacionin e tij i mungojnë këto të dhëna: përfundimi financiar, projekti ideor, pasqyrat financiare, qarkullim në 5 vitet e fundit dhe letër përkrashja.
9. Në momentin që kemi pasur qasje në ofertën e fituesit, kemi vërejt se në aplikacionin e tij i njëjti nuk pasur fare ofertë, nuk ka pasur pasqyra financiare dhe as qarkullim në 5 vitet e fundit, po ashtu edhe pse është kërkuar garancion bankar aty është një deklaratë e një kompanie sigurimi që nuk është garancion bankar.

Provë: Mënyra e Vlerësimit të Komisionit Vlerësues të datës 09.10.2020;

10. Njoftimi publik i datës 14.09.2020, njoftimi për vlerësimin e ofertave i datës 09.10.2020, si dhe dokumenti i Vlerësimit i datës 09.10.2020 konsistojnë në shkelje të dispozitave të procedurës Administrative, të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të drejtës materiale përkatësisht dispozitave të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

I. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

1. Komisioni vlerësues ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për shkak se në bazë të Konkursit të shpallur me datë 16.09.2020, me numër Nr. 01/462/01-38720 janë paraparë kriteret për pjesëmarrje dhe vlerësim në konkurs dhe atë si vijon:

- Oferta Ekonomikisht më e favorshme
- Vlera e Investimit
- Numri i të punësuarëve nga Investimi
- Lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën
- Përfundim financiar dhe ekonomik i komunës

kurse të njëjtit kanë paraparë edhe kriteret se cilat dokumente duhet të paraqiten me rastin e aplikimit siç janë:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe veprimtaria e përshtatshme
- Për personat fizik, certifikatën e nënshtetësisë
- Projekti ideor i investimit
- Për personat juridik pasqyrë financiare të audituara dhe qarkullimin bankar në pesë vitet e fundit

- Çirimi bankare prej 30% të vlerës së investimit të projektit
 - Afati i realizimit të projektit të investimit është 18 muaj.
2. Ankuesi në bazë të kriterëve të konkursit ka aplikuar dhe ka dorëzuar ofertën e datës dhe i ka bashkëgjuhur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në bazë të konkursit. Ankuesi duke parë që përmes njoftimit të datës 09.10.2020 i njëjti nuk është shpallur fitues, ndërsa për parcelën të cilën ka aplikuar është shpallur fitues personi fizik Ragip Veseli.
 3. Ankuesi me bindjen që i njëjti i ka plotësuar kriteret e lartëcekura dhe i njëjti padrejtësisht nuk është shpallur fitues, me datë 12 tetor 2020, në përpunje me Njoftimin Publik, i cili parashih që pjesëmarrësit në këtë proces kanë të drejtë të kenë qasje në dokumentacionet e pronës si dhe të informohen në lidhje me procedurat e shprehjes së interesit, kanë paraqitur kërkesë për qasje në dokumentacionin – ofertën e fituesit për parcelën për të cilën ka aplikuar Ankuesi, sipas konkursit publik të paraqitur me datë 16.09.2020. (Shih Kërkesa për qasje në dokumentacionin e fituesit e datës 13.10.2020).
 4. Me datë 16.10.2020 ju është ofruar qasja në dokumentacion dhe aty është vërejtë se: në projektin/ofertën e ankuesit dhe në vlerësimin e bashkëlidhur të siguruar pas qasjes në dokumentacion, provohet se ankuesi vlerën e investimit e ka më të lartë se fituesi, po ashtu numrin e punëtorëve e ka më të lartë se fituesi dhe i plotëson kërkesat sipas ftesës për ofertë.
 5. Komisioni vlerësues me rastin e vendosjes nuk ka vërtetuar gjendjen faktike dhe gjithashtu nuk ka vërtetuar faktin nëse Ankuesi ka plotësuar kriteret e kërkuara me konkursin dhe nëse janë plotësuar kushtet për shpalljen e fituesit dhe gjithashtu konsiderojmë që Ankuesi është person juridik i cili disa vite më rëndë është shpallur si tatimpaguesi më i madhë dhe punëdhënësi më i madhë në Republikën e Kosovës.
 6. Ankuesi ka pasur vlerën më të madhe të investimeve në mbi 4 milion, ka pasur numrin më të madhë të të punësuarve, përfutim për komunën ka qenë shumë dimensional duke përfshirë në vlerën e investimit, numrin e punëtorëve, përfutimin publik të komunës, nuk e ka projektin ideor etj.
 7. Pasi patëm qasje në dokumentacion e konkursit dhe ofertën e fituesit kemi vërejtur se arsyetimi i komisionit vlerësues është që Ankuesi nuk ka vendosur çmimin tek rubrika e çmimit të aplikacionit, dhe nuk ka paraqitur përfutimin financiar dhe ekonomik të Komunës. Kjo nuk qëndron pasi lehtë në aplikacionin e Ankuesit dhe Projektin e tij shihet qartë se Ankuesi ka vendosur çmimin dhe atë njëjtë sikur Fituesi përkundër që kjo rubrikë ka qenë e pagartë pasi nuk ka detajizuar se cili çmim duhet të vendoset, çmimi total i investimit apo çmimi për metër katror. Pra në asnjë mënyrë nuk ka pasur qartësi në rubrikën e çmimit. Ndërsa aplikuesi në ofertën e bashkëlidhur së bashku me aplikacion ka

pasur të specifikuar çmimin e investimit po ashtu edhe në rubrikën e ka pasur të cekur një vlerë. Në projekt në mënyrë të detajuar është elaboruar përfitimin financiar dhe ekonomik të Komunës. Gjithashtu, edhe plani ideor i ankuesit në mënyrë të detajuar ka qenë pjesë e projektit, përkundër që në vlerësimin e komisionit ky kusht është i evidentuar si i paplotësuar. Po ashtu edhe gjendja e llogarisë bankare ka qenë pjesë e ofertës në formë të CD-se, përkundër që është evidentuar që mungon nga komisioni i vlerësimit.

3. Po ashtu oferta e Fituesit Ragip Veseli nuk i ka përmësuar kërkesat e ofertës për arsye se të njëjtit nuk i dihen pasyrat financiare, nuk i dihet nëse ka pasur qarkullim në 5 viter e fundit, nuk i dihet prejardhja e parave, e ka numrin më të vogël të të punësuarve, ka investim më të vogël se Ankuesi. Po ashtu në konkurs është kërkuar garancion bankar ndërsa Fituesi ka paraqitur një deklaratë prej një kompanie të sigurimit. Kjo deklaratë nga kompania e sigurimit nuk është e njëjtë dhe nuk ka siguri sikur garancioni bankar, pra nuk i plotëson kërkesat e konkursit publik.

II. Shkelja e dispozitave të procedurës Administrative

1. Duhet të theksohet se Komisioni vlerësues me rastin e nxjerrjes së Njoftimit me numër Nr. 01/462/01-38720, kanë bërë shkelje të dispozitave që rrjedhin nga Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
2. Njoftimi është nxjerrë në kundërshtim me nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që këtij Njoftimi të lartëcekur i mungon forma e paraparë me dispozitat e lartëcekura e të cilat janë të detyrshueshme me rastin e nxjerrjes së një Njoftimi nga një organ administrative.
3. Neni 47 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative thuhet se elementet e detyrueshme të aktit administrativ janë : pjesa hyrëse, pjesa urdhëruese (dispozitiv), pjesa arsyetuese dhe pjesa përfundimtare si dhe këshilla juridike.
4. Njoftimi i nxjerrë nga Komisioni vlerësues është nxjerrë në kundërshtim me nenin 48 për shkak se i njëjti është i mangët dhe nuk ka fare pjesë arsyetuese se për se i'u është refuzuar oferta Ankuesit dhe cilat kushte nuk i ka plotësuar, kurse në anën tjetër i'u është dhënë e drejta e ankesës, mirëpo që njoftimi nuk ka dispozitiv, i cili do të atakohej.
5. Paragrafi 1 i nenit 48 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka paraparë që arsyetimi duhet të përmbajë:
 - Paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;
 - Shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë Njoftimi
 - Shkaqet të cilat kanë qenë Njoftimtare gjatë vlerësimit të provave
 - Bazën ligjor të Njoftimit dhe arsyen se përse është zbatuar në rastin konkret

- Shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palës

Në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpejtimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në Njoftim.

Kurse në paragrafin 2 të po të njëjtit nen është paraparë që nëse një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtthënës apo i pakuptueshëm është i barabartë me mungesën e tij. Pra Njoftimi i dhënë, nuk përmbanë asnjë arsyetim i vlerësimit të ofertave dhe as shkaqet për refuzim.

- Duke u bazuar në dispozitën e nenit 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe në Njoftimin e nxjerrë nga Komisioni vlerësues, mund të vijmë në përfundim që i njëjti njoftim nuk përmbanë arsyetim mbi faktet Njoftimtare ashtu siç është spejguar nga gjendja faktike. Është i pamjaftueshëm për shkak se nuk ka spejguar faktet Njoftimtare mbi të cilat është marrë njoftimi, është kundërtthënës për shkak mungon arsyetimi sa i përket pjesës së dispozitivit si dhe nuk është spejguar se mbi cilën bazë ligjore është nxjerrë ky njoftim. Bazuar në paragrafin 2 të nenit 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative mund të konkludojmë se nga të gjitha mungesat e lartëcekura, ky njoftim nuk përmban fare arsyetim ashtu siç parashihet me nenin 47 të po të njëjtit ligj.

II. Aplikimi i gabueshëm i dispozitave materiale


- Komisioni vlerësues me rastin e nxjerrjes së Njoftimit në lidhje me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, konkretisht dispozitën e nenit 19 i cili parashihet se si bëhet vlerësim i ofertave e cili nen parashihet "*Komisioni vlerësues, pas pranimit të ofertave e bën vlerësimin e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik. Njoftimin për përzgjedhjen e ofertave komisioni e publikon në faqen zyrtare të komunës, si dhe të njëjtin ja dërgon palëve të përfshira në proces*".
- Komisioni vlerësues nuk ka bërë vlerësimin e ofertave në përputhje me nenin 19 ashtu siç u spejguar më lartë dhe në Njoftimin e nxjerrë në asnjë moment nuk kanë bërë vlerësimin në bazë të kriterëve të përcaktuara me konkursin publik të shpallur nga vetë Komuna e Drenasit dhe të njëjtit nuk kanë dhënë asnjë sqarim nëse ankuesi nuk ka përmbushur ndonjërin nga kriteret e njoftimit publik apo nga kriteret e përcaktuara, komisioni ka vlerësuar se fituesi shpallet Ragip Veseli duke mos dhënë asnjë arsyetim më tepër.
- Vlenë të theksohet se edhe në bazë të planit të biznesit të "Abi" Sh.p.k, i cili është punëpaguesi më i madhë në Kosovë dhe ka numrin më të madhë të punëtorëve, ka paraparë investim në shumën që tejkalon shumën prej rreth 4.000.000 (katër milion euro) dhe të punësojë përafërsisht rreth 110 të punësuar. Në asnjë rast vlerësojmë që fituesi i shpallur, ka plotësuar ndonjë nga kriteret e njoftimit publik në mënyrë më bindëse se Ankuesit. *(shih planin e biznesit të Ankuesit dhe formën e vlerësimit të komisionit vlerësues).*

4. Për më shumë edhe Njoftimi publik i datës 14.09.2020 është në kundërshtim me dispozitave të Ligjit nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palunjtshme të Komunës pasi ka vendosur kritere tjera për persona fizik dhe tjera për persona juridik. Përsoneat fizik nuk kanë pasur për obligim që të paraqesin pasyqrat financiare, gjendjen e llogarisë bankare e që janë dy prova kruciale që vërtetojnë seriozitetin e investimit.

Duke u bazuar në thëniet e lartëcekura, shkeljet e bërë të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, shkeljet e Dispozitave të Ligjit nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palunjtshme të Komunës dhe duke u bazuar në nenin 20 paragrafi 2, kërkojnë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave që pas shqyrtimit të ankesës së ankuesit të nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET ankesa e ankuesit "ABI" Sh.p.k, me numër unik identifikues 80180187, adresë në Rr. Tirana, Prizren, të cilën përmban autorizimit e përfaqëson Avokat Taulant Hodaj, me seli në Rr. Fehmi Agani 79/8, Prishtinë.
- II. ANULOHET Njoftimi i Komisionit vlerësues me numër nr. Nr. 01/462/01-38720, i nxjerrë me datë 09.10.2020, dhe i pranuar nga ankuesi me datë 12.10.2020, SI I KUNDËRLIGJSHËM.
- III. ANULOHET Njoftimi Publik i Komisionit vlerësues, i nxjerrë me datë 14.09.2020, SI I KUNDËRLIGJSHËM.
- IV. MIRATOHET Oferta e Ankuesit e "ABI" Sh.p.k, me numër unik identifikues 80180187, adresë në Rr. Tirana, Prizren, SI E PLOTË DHE E BAZUAR.
- V. PROCEDOHET për plotësim dhe ndryshim Njoftimi Publik i Komisionit vlerësues PËR APROVIM NË KUVENDIN KOMUNAL TË GLLOGOCIT.



Për dhe në emër të "ABI" Sh.p.k

Taulant Hodaj, Avokat

AUTORIZIM

"Abi" sh.p.k. me numër të biznesit 80180187 dhe numër fiskal 600037552, me seli në Prizren, rruga "Tirana", pa numër, të cilën e përfaqësonë pronari dhe drejtori Bari Fusha, i.



HODAJ & PARTNERI
ADVOKAT

AUTORIZOJNË

Avokat TAULANT HODAJ, me numër të licencës 1282/2013, me seli në Prishtinë, Rr. Fehmi Agani Nr.79,

Avokat ENGJELL REXHEPI, me numër të licencës 1604/2017 me seli në Prishtinë, Rr. "Fehmi Agani" Nr.79/8, dhe

Attorneys / Advokati

Taulant HODAJ
Engjell REXHEPI
Fatos ZEQRIRI

in cooperation with
Reinhard KIRPEL
Offenburg/Germany

Avokat FATOS ZEQRIRI, me numër të licencës 1698/2018 me seli në Prishtinë, Rr. "Fehmi Agani" Nr.79/8,

Str. Fehmi Agani 79
10 000 Prishtine

info@hodajlaw.com
www.hodajlaw.com

Tel. +381 00 713 777
Mob. +377 44 387 558

që në emër dhe për llogari të kompanisë "Abi" sh.p.k të më përfaqësojnë në çështjet gjyqësore dhe jashtëgjyqësore të çdo lloji në të gjitha procedurat gjyqësore dhe të jashtëgjyqësore të të gjitha instancave, si dhe të bëjnë përfaqësimin para të gjitha institucioneve tjera, me këto autorizime:

1. Të paraqesin propozime dhe kërkesa, të parashtrajnë mjete juridike të rregullta dhe jashtëzakonshme, të tërhiqen nga to pjesërisht po në tërësi apo që edhe të heqin dorë nga to dhe njëjtat t'i kufizojë në aktgjykim apo masat penale, si dhe të pranojnë të gjitha parashtrësat, njoftime, lajmërimet dhe shkresat, aktgjykimet dhe aktvendimet;
2. Të tërheqin dokumente në emër dhe për llogari të kompanisë para institucioneve të ligjshme në gjykatë, në komunën përkatëse, polici si dhe institucione tjera publike.
3. Të bëjnë përfaqësimin para gjykatës, prokurorisë, organeve tjera të drejtësisë, organeve administrative, administratës tatimore dhe organeve tjera sipas nevojës.
4. Të bëjë përfaqësimin e kompanisë pranë Administratës Tatimore të Kosovës.
5. Të bëjnë bartjen e pjesërishtme apo të tërësishme të autorizimit në persona të tjerë.
6. Ky autorizim vlen prej datës së nënshkrimit, dhe vlen në kohë të pafund deri nëse nuk revokohet me shkrim nga ana ime si Drejtor i Kompanisë.


Data: 03 tetor 2018

Dhënësit e Autorizimit

Bari Fusha
(Drejtori i kompanisë)
Bari Fusha



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit



Nr 01-462/01-45421 dt. 26/10/2020

Komisioni i Ankesave i formuar sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit 12 Nr. 400-23072, të datës 02.05.2019, në përputhje me Ligji Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke vendosur sipas ankesës Nr.R-9846299, të datës 16.10.2020, lidhur me njoftimin Publik Nr.01-462/01-38720, të datës 16.09.2020, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme Komunale, rrjedhimisht njoftimit të Komisionit Vlerësues për Vlerësimin e Ofertave për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës, për shpallje të fituesve të ofertave ekonomikisht me të favorshme Nr. 01-462/01-43186, të datës 09.10.2020, për parcelën kadastrale Nr.P-70314035-01979-0, në sipërfaqe 12111.0 m², në zonën kadastrale në Komoran, vendi i quajtur "Fush Gjer", Komisioni i Ankesave, në takimin e datës 23/24/25/26 Tetor 2020, mori këtë:

V e n d i m

Refuzohet si e pabazuar ankesa Nr.R-9846299, e datës 16.10.2020, e ofertuesit "Abi" Shpk, ndërsa njoftimi i Komisionit Vlerësues për Vlerësimin e Ofertave për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës, për shpallje të fituesit Nr.01-462/01-43186, i datës 09.10.2020, për parcelën kadastrale Nr.P-70314035-01979-0, në sipërfaqe 12111.0 m², në zonën kadastrale në Komoran", mbetet në fuqi.

A r s y e t i m

Komuna e Drenasit, respektivisht Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit, me datë 16.09.2020, ka bërë shpalljen e njoftimit publik Nr.01-462/01-38720, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme Komunale.

Me datë 02.10.2020, komisioni ka bërë hapjen e ofertave për dhënien e pronave Komunale në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite në Komunën e Drenasit, me ofertuesit pjesëmarrës gjatë hapjes së ofertave.

Komisioni vlerësues ka filluar me vlerësimin e ofertave me datë 05.10.2020 dhe ka vazhduar deri më datë 08.10.2020, bazuar në Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe

Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullore (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, rrjedhimisht kriteret e përcaktuara sipas akteve të lartcekura.

Më datë 09.10.2020, Komisioni Vlerësues për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, shpall njoftimin për ofertat fituese Nr. 01-462/01-43186.

Ofertuesi "Abi" Shpk. me datë 16.10.2020, ka parashtruar Ankesë Nr.R-9846299, në të cilën ka kërkuar të anulohet njoftimi i datës 09.10.2020, për parcelën kadastrale Nr.P-70314035-01979-0, në sipërfaqe 12111.0 m², në zonën kadastrale në Komoran, vendi i quajtur "Fush Gjer".

Sa i përket pretendimeve të ankuesit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës Administrative, të konstatimit të gabuar apo jo të plote të gjendjes faktike, të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, nga Komisioni Vlerësues për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, Komisioni i ankesave ka konstatuar se, Vlerësimi i Ofertave, është bërë bazuar në Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe në Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në të cilën në nenin 20, paragrafi 1 përcaktohen Kriteret për zgjedhjen e ofertave, 1.1 Oferta ekonomikisht më e favorshme që përfshinë: 1.1.1 Vlera e investimit, 1.1.2 Numri i të punësuarve nga investimi, 1.1.3 Lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën, Përfitimi financiar dhe ekonomik i Komunës, 1.1.5 Kriteret të tjera të cilat mund të përcaktohen me konkurs.

Është konstatuar se ofertuesi "Abi" Shpk sipas procesverbalit dhe dokumentacionit në kriterin e përcaktuar përfitimin ekonomik dhe financiar të Komunës, ankuesi nuk ka plotësuar këtë kriter duke mos paraqitur përfitimin ekonomik të Komunës, çka bie ndesh me kriteret e përcaktuara sipas Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Në kriterin tjetër të përcaktuar me njoftim publik Nr.01-462/01-38720, të datës 16.09.2020, kriteret e tjera të përcaktuara me konkurs, projekti ideor i investimit nuk është plotësuar si kriter nga ofertuesi dhe ka prezantuar vetëm dy skica dhe një pozicionim të objektit për parcelën kadastrale, ku kishte aplikuar, të prezantuar sipas ortofotos zyrtare nga KGP-ja.

Në kriterin tjetër të përcaktuar me konkurs në të cilën është kërkuar pasqyra për personat juridik të audituara dhe qarkullimin bankar në 5 vitet e fundit, i njëjti ka prezantuar pasqyrën financiare vetëm për vitin 2019.

Sipas dokumentacionit ankuesi me datë 13.10.2020. ka bërë kërkesë për qasje në dokumente publike. ndërsa me datë 16.10.2020. në sallën e Kuvendit të Komunës iu është ofruar qasje në dokumente publike. sipas vendimit Nr.01-030/01-44262, të datës 15.10.2020. ndërsa qasje vizuale iu është ofruar në të gjitha dokumentet e kërkuara.

Andaj, duke pasur parasysh nga të gjitha që u thanë më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicojë kontestin administrativ në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Anëtarët e komisionit të anketës:
1. Armend Hajdini
2. Rinore Zymeri
3. Adem Bucelli
4. Sokol Bylykbashi
5. Alban Bujupi

Iu dërgohet:

- *Kuvendit të Komunës
- *Komisionit Vlersues
- *Palës
- *Arkivit

Nr. 05 / 10 / 2020			
Dok. Nr.	Numër	Shifra	Vlera
27	252/Pl. 10.00		



REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GLOGOCIT • OPSTINA GLOGOVAC • MUNICIPALITY OF GLOGOC



Pas përfundimit të vlerësimit të ofertave të konkursit publik të shpallur më 17.09.2020 me numër 01-Nr.462/01-38720 dhe të mbyllur me datë 30 shtator 2020, Komisioni Vlerësues i Ofertave për dhënie të pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, me datë 09.10.2020, jep këtë:

NJOFTIM

Për Parcelën Kadastrale nr.P-70315016-01015-1, në sipërfaqe të përgjithshme 17733.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Balta-Balta", Zona Kadastrale Glogoc, sipas vlerësimit të komisionit, fitues shpallet:

- IP Kos shpk

Për Parcelën Kadastrale nr.P-70314035-00202-1, në sipërfaqe të përgjithshme 3710.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fshat-Fshat", Zona Kadastrale Komoran, sipas vlerësimit të komisionit, fitues shpallet:

- Elkos shpk

Për Parcelën Kadastrale nr.P-70314035-01979-0, në sipërfaqe të përgjithshme 12111.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fush- Gjer", Zona Kadastrale Komoran, sipas vlerësimit të komisionit, fitues shpallet:

- Ragip Veseli

Për Parcelën Kadastrale nr.P-70310058-02652-2, në sipërfaqe të përgjithshme 3746.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Ara të Zabeli", Zona Kadastrale Arllat, sipas vlerësimit të komisionit, fitues shpallet:

- IP Kos shpk

Për Parcelën Kadastrale nr.P-70315015-00764-0, në sipërfaqe të përgjithshme 6363.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Mahalla Binakve", Zona Kadastrale Gllobar, sipas vlerësimit të komisionit, fitues shpallet:

- Fer Petrol

Për Parcelën Kadastrale nr.P-70314035-01931-0, në sipërfaqe të përgjithshme 3263.0 m², në vendin e quajtur "Fush-Gjer", Zona Kadastrale Komoran

- Nuk ka fitues për arsye se janë dorëzuar Oferta të pa kompletuara dhe nuk paraqesin seriozitet të ofertës për këtë parcelë kadastrale në procesin e konkurimit publik

Për Parcelën Kadastrale nr.P-70314035-01930-0, në sipërfaqe të përgjithshme 2003.0 m², në vendin e quajtur "Fush-Gjer", Zona Kadastrale Komoran

- Nuk ka Oferta të pranuar për këtë parcelë kadastrale në procesin e konkurimit publik

Palët e pakënaqura nga procesi i vlerësimit të ofertave nga komisioni për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, mund të paraqesin ankesë brenda shtatë (7) ditëve kalendarike në Komisionin e ankesave.

Komisioni Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës



RAPORTI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE

Konkurimi publik për dhënie të pronave të paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite

Informata rreth ofertimit: Njoftimi publik 01-Nr.462/01-38720 dt. 16.09.2020

Data e shpalljes së Njoftimit Publik: 16.09.2020

Data e hapjes së ofertave: 02.10.2020, ora 09:00, sala e kuvendit komunal në Glllogoc

Data e raportit të vlerësimit të ofertave: 05, 06, 07 tetor 2020, sala e bordit në Komunen e Glllogocit

Numri i ofertuesve pjesëmarrës në konkurim publik: 18

Ofertuesit, për Parcelën Kadastrale P-70315016-01016-1, në sipërfaqe të përgjithshme 17733.0 m², në vendin e quajtur "Balta-Balta", Zona Kadastrale Glllogoc

- IP Kos shpk
- Tehno Burimi
- Naser Ramaj
- Elkos shpk
- Valdrini shpk & Shkambi
- Fer Petrol

Ofertuesit, për Parcelën kadastrale nr.P-70314035-00202-1, në sipërfaqe të përgjithshme 3710.0 m², në vendin e quajtur "Fshat-Fshat", Zona Kadastrale Komoran

- Elkos shpk
- NTP Te Luli
- NTP Inter Commerce

Ofertuesit, për Parcelën Kadastrale nr.P-70314035-01979-0, në sipërfaqe të përgjithshme 12111.0 m², në vendin e quajtur "Fush- Gjer", Zona Kadastrale Komoran

- Shpk Abi
- Ragip Veseli
- Valon Ajazi

Ofertuesit për Parcelën kadastrale nr.P-70314035-01931-0, në sipërfaqe të përgjithshme 3163.0 m², në vendin e quajtur "Push Bjer", Zona kadastrale Gomoran

- DPT Next Plast
- NTP Inter Commerce

Ofertuesit për Parcelën kadastrale nr.P-70310058-02652-2, në sipërfaqe të përgjithshme 3746.0 m², në vendin e quajtur "Ara të Zabej", Zona kadastrale Arllat

- Autoshkolla Albioni
- IP Kos shpk
- Benita Company shpk

Ofertuesit për Parcelën Kadastrale nr.P-70315015-00764-0, në sipërfaqe të përgjithshme 6863.0 m², në vendin e quajtur "Mahalla Binakve", Zona Kadastrale Gillobar.

- Far Petrol

Kriteret për Vlerësimin e Ofertave sipas Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe kembimin e pronës së paluajtshme të komunes, Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Kembimin e Pronës së Paluajtshme të Komunes,

Oferta ekonomike më e favorshme e cila përfshin:

- Vlera e investimit;
- Numri i të punësuarve;
- Lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën;
- Perfitimi financiar dhe ekonomik i komunes;

Dokumentacioni i kërkuar sipas kriterave të tjera të përcaktuara në konkurs

- Certifikata e Regjistrimit të Biznesit dhe veprimtaria e përshtatshme;
- Për personat fizik certifikatën e nënshtetësisë;
- Projekti Ideor i Investimit;
- Për personat juridik pasqyre financiare të audituara dhe qarkullimin bankar në pesë (5) vitet e fundit;
- Garanci bankare prej rreth 30 % të vlerës së investimit të projektit.

REKOMANDIMI I KOMISIONIT PËR PERZGJEDHJEN E FITUESIT

Për Parcelën Kadastrale P-70315016-01016-1, në sipërfaqe të përgjithshme 17733.0 m², në vendin e quajtur "Balta-Balta", Zona Kadastrale Glllogoc

- IP Kos shpk

Për Parcelën Kadastrale nr.P-70314035-00202-1, në sipërfaqe të përgjithshme 3710.0 m², në vendin e quajtur "Fshat-Fshat", Zona Kadastrale Komoran

- Elkos shpk

Për Parcelën Kadastrale nr.P-70314035-01979-0, në sipërfaqe të përgjithshme 12111.0 m², në vendin e quajtur "Fush-Gjer", Zona Kadastrale Komoran

- Ragip Veseli

Për Parcelën Kadastrale nr.P-70314035-01981-0, në sipërfaqe të përgjithshme 3263.0 m², në vendin e quajtur "Fush-Gjer", Zona Kadastrale Komoran

- Nuk ka Oferta serioze të pranuar për këtë parcelë kadastrale në procesin e konkurimit publik

Për Parcelën Kadastrale nr.P-70314035-01980-0, në sipërfaqe të përgjithshme 2003.0 m², në vendin e quajtur "Fush-Gjer", Zona Kadastrale Komoran

- Nuk ka Oferta të pranuar për këtë parcelë kadastrale në procesin e konkurimit publik

Për parcelën Kadastrale nr.P-70310058-02652-2, në sipërfaqe të përgjithshme 3746.0 m², në vendin e quajtur "Ara të Zabeli", Zona Kadastrale Arllat

- IP Kos shpk

Për Parcelën Kadastrale nr.P-70315015-00764-0, në sipërfaqe të përgjithshme 6853.0 m², në vendin e quajtur "Mahalia Binakve", Zona Kadastrale Glllobar

- Fer Petrol

Anëtarët e Komisionit Përfutësues:

- Flutura Avdiu, Kryesuese
- Safet Hoxha, anëtar
- Florentina Kukaj, anëtar
- Sabrije Kukaj, anëtar
- Arben Kuliqi, anëtar





REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GLLOGOCIT • OPSTINA GLOGOC • MUNICIPALITY OF GLOGOC



KOMISIONI VLERESUES PER DHENIEN NE SHFRYTEZIM TE PRONES SE PALUAJTSHME TE KOMUNES SE GLLOGOCIT

Duke u bazuar ne nenet 2, 3 paragrafi 1.4, nenin 4 paragrafi 1 nenparagrafet 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, nenin 6 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1, nenit 14, 17, 19 te Ligjit Nr.06/L-092, per dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 19 paragrafi 1, nenit 13, 15, 20, 21 në Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, zbatimit të Vendimit 12-Nr.464-35592 dt 31.03.2020 për miratimin paraprak për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës së Glogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik, Komisioni Vlerësues i ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë me vendim të Komandit të Komunës së Glogocit 12-Nr.400-2019 të datës 02.05.2019, në mbledhjen e mbajtur në datë 14.09.2020, vendos për shpallje:

NUOFTIM PUBLIK

Për dhënie në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale

Konkurimi publik për dhënie e pronave të paluajtshme në pronësi të Komunës, përmban si në vijim:

- Parcela Kadastrale nr.P-70315016-01016-1, në sipërfaqe të përgjithshme 17733.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Balta-Balta", Zona Kadastrale Gliogoc
- Parcela Kadastrale nr.P-70314035-00202-1, në sipërfaqe të përgjithshme 3710.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fshat-Fshat", Zona Kadastrale Komoran
- Parcela Kadastrale nr.P-70314035-01930-0, në sipërfaqe të përgjithshme 2003.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fush Gjer", Zona Kadastrale Komoran
- Parcela Kadastrale nr.P-70314035-01979-0, në sipërfaqe të përgjithshme 12111.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Fush Gjer", Zona Kadastrale Komoran
- Parcela Kadastrale nr.P-70314035-01931-0, në sipërfaqe të përgjithshme 3342.0 m²

që gjendet në vendin e quajtur "Fushë-Gjeri", Zona Kadastrale Komoran.

- Parcela kadastrale nr.P-70310053-02652-2, në sipërfaqe të përgjithshme 3746.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Ana të Zabej", Zona Kadastrale Arllat.

- Parcela Kadastrale nr.P-70315015-00764-0, në sipërfaqe të përgjithshme 6863.0 m², që gjendet në vendin e quajtur "Mahalla Binakve", Zona Kadastrale Gillobar.

Afati i dhënies në shfrytëzim

- Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është afatgjatë dari në nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

Veprimtaria që ushtrohet sipas destinimit të pronës

- Parcelat të theksuara më lartë janë të destinuara për biznes-zona industriale me Plan Zhvillimor Komunal të Gillogodit.

Kriteret për vlerësimin e ofertave

- Oferta ekonomike më e favorshme;
- Vlera e investimit;
- Numri i të punësuarve nga investimi;
- Lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën;
- Përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës;

Kriteret të tjera të cilat përcaktohen me konkurs

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe veprimtaria e përshtatshme;
- Për personat fizik certifikatën e nënshtetësisë;
- Projekti Ideor i Investimit;
- Për personat juridik pasqyrë financiare të audituara dhe çarkullimin bankar në pesë (5) vitet e fundit;
- Garanci bankare prej rreth 30 % të vlerës së investimit të projektit;
- Afati i realizimit të projektit të investimit është 18 muaj.

Pjesëmarrësit në këtë proces kanë të drejtë:

- Të informohen lidhur me procedurat e shprehjes së interesit,
- Të shohin pronën që jepet në shfrytëzim,
- Të kenë qasje në dokumentacionet e pronës,
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.

Perdurimi e telefonverës së njëzimit publik do të jetë 15 ditë kalendrike, përfatësimi nga 15.09.2020-30.09.2020


Oferat: Komuna e Drenasit përfshijë edhe shërbimet që do të ofrohen drejtpërdrejtë në Komunën e Drenasit sipas kushtit 11.11 në aneksimin 10 që shprehë kushtet e ofrimit të shërbimeve të ofruara. Për më tepër: Përshkrimi i shërbimeve 10.003 Drenas

Vendi, koha ku do të mbahet konkurimi publik:

- Në sallën e Kryeshtet Komunal, me datë 02.10.2020, në fillim në ora 09:00, do të bëhet hapja e ofertave dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në konkurs publik.

Të interesuarit mund të informohen çdo ditë punë përmes Ueb faqës së Komunës <https://ksh-ke.gov.net/gjergov/>, Tel. 03320040312, E-mail-it zyrtar.komuna.drenas@rks-gov.net.

Qendër e Drenasit



Republika e Kosovës
Komuna Glogoc
Kuvendi i Komunës

Nr: 42-454-35992 dat. 31/08 2020

Baruar në nenin 11, 12 dhe 40, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 34, pikë 34.6. e Statutit të Komunës së Glogocit, në bazë të nenit 5, 6, 7, 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në bazë të nenit 5 paragrafi 1.3 të Rregullores QRK-Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.08.2020, miratoj këtë:

V E N D I M

Për miratimin paraprak të Vendimit për Dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Glogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Glogocit të miratoj Vendimin për miratimin paraprak të Vendimit për Dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Glogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik.

Neni 2

Prona e paluajtshme të propozuara për dhënie në shfrytëzim të cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi është:

1. Për shfrytëzimin afatgjatë (15 deri në 99 vite)

Zona Kadastrale Glogoc

-Ngastra kadastrale nr.01016-1 me sipërfaqe S=1.77.33 ha

Zona Kadastrale Komoran

-Ngastra kadastrale nr.00202-1 me sipërfaqe S=0.37.10 ha

-Ngastra kadastrale nr.01986-0 me sipërfaqe S=0.20.03 ha

-Ngastra kadastrale nr.01979-0 me sipërfaqe S=1.21.11 ha

-Ngastra kadastrale nr.01981-0 me sipërfaqe S=0.32.63 ha

Zona Kadastrale Arlier

-Ngastra kadastrale nr.02652-3 me sipërfaqe S=0.37.46 ha

Zona Kadastrale Glllogar

-Ngastra kadastrale nr.00764-0 me sipërfaqe S=0.68.63 ha

Të gjitha këto lokacione janë pronë e Kuvendit Komunal Glllogoc.

Neni 3

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për periudhë afatgjatë, do të bëhet përmes procesit të Konkursit publik për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe procedurave të parapara me Ligjin Nr.06/L-092 për: Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.


Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drektorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit.

Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministërstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glogocit
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MPL-së
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Data: 03.09.2020 Nr.020-632
Zyrtaret përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glogocit
Lloji i aktit:	□ Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim paraprak i Kuvendit të Komunës Nr. 12-464-35992 për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Glogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik
I miratuar më datë: 31.08.2020
I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 01.09.2020

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përrabajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA GLOGOC
GLOGOC MUNICIPALITY

02/10/2020 Rapja e ofertave për dhënie e pronave komunale në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, në komunën e Glogocit

Titull	Numër	Shtojca	Vlera
01-	462	41981	

Ofertat e pranuar për parcelën me nr. P-70315016-01016-1, në zonën kadastrale Glogoc

Nr.	Kompania Ofertuese	Vlera e investimit	Numri i të pranuarve	Lloji i investimit	Përfundim Ekonomik, Financiar i Komunitetit	Nëntësimi i Ofertuesit
1	IP - KOS Sh.p.k	4,100.00	120	Papërmblim	2,660.00	
2	TEHNO BURIMI	3,802.00	150	Qendër tregtare	2020.00	
3	NASAT Ramov	4,100.00	113	Qendër tregtare	1,063.00	
4	ELKOS Sh.p.k	2,040.00	80	Qendër tregtare	3,500.00	
5	Valdimi Sh.p.k, me kompani	1,700.00	80	Sipër projekt	Mungon	
6	FER PETROL	4,201.35	101	Qendër tregtare	2,500.00	

Ofertat e pranuar për parcelën me nr. P-70314035-00202-1, në zonën kadastrale Komoran

1	ELKOS Sh.p.k	4,530.00	25	Qendër tregtare	1,000.00	
2	NTP "Të LUTI"	4,500.00	Mungon	Sipër projekt	Mungon	
3	NPT "INTER COMMERCE"	130.00	15	Qendër tregtare	1,000.00	

Ofertat e pranuar për parcelën me nr. P-70314035-01980-0, në zonën kadastrale Komoran

1						
2						

Ofertat e pranuar për parcelën me nr. P-70314035-01979-0, në zonën kadastrale Komoran

1	Sh.p.k. "ABII"	3,300.00	110	Qendër tregtare	1,000.00	
2	Rajp Veseli	2,000.00	50	Qendër tregtare	1,000.00	
3	Valom Ajazi	Mungon	15	Qendër tregtare	1,000.00	

Ofertat e pranuar për parcelën me nr. P-70314035-01981-0, në zonën kadastrale Komoran

1	DPT NEXT PAST	6,500.00	16	Qendër tregtare	1,000.00	
2	NPT INTER COMMERCE	1,300.00	15	Qendër tregtare	1,000.00	

Ofertat e pranuar për parcelën me nr. P-70310058-02652-2, në zonën kadastrale Arllat

1	Autosikolla "Albion"	2,032.40	13	Qendër tregtare	1,000.00	
2	IP - KOS Sh.p.k	3,500.00	24	Qendër tregtare	1,000.00	
3	Bemita Company Sh.p.k	8,000.00	40	Qendër tregtare	1,000.00	

Ofertat e pranuar për parcelën me nr. P-70315015-00764-0, në zonën kadastrale Gllobar

1	FER PETROL	501.00	37	Qendër tregtare	1,000.00	
---	------------	--------	----	-----------------	----------	--

Anëtarët e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Anëtarët

Anëtarët

Anëtarët

Anëtarët

Flutura Avdiu

Safet Hoxha

Sabrie Kukaj

Arben Kufiqi

Florentina Kukaj



Ofertat e pranuarat per parcelen me nr.P-70315016-01016-1, zona kadastrale Gillogoc

Nr.	Vlera e Investimit	Numri i te Duresuarve	Uloji i Investimit	Perfitimi Financiar, Ekono miki i Komunes	Certifikata e Regjistrimit te Biznesit	Per personat fizik certifikaten e nenshtetesise	Projekti Ideor te Investimit	Per personat juridik pasqyrtat financiare audituara, qarkullim i bankar ne 5 vitet e fundit	Garanci bankare	Sigurim bankar	Letet perkrabhe
1	1p Kos Shpk	4,100,000.00	120	2.6%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
2	Tehno Burtimi	3,000,000.00	150	2.0%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
3	Naser Ramaj	4,000,000.00	143	4.1%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
4	Elkos Shpk	4,040,544.30	80	3.5%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
5	Valdriti Shpk BSHKEMI	1,700,000.00	50	1.1%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
6	Fer Petroll	4,201,554.35	104	2.5%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓

Ofertat e pranuarat per parcelen me nr.P-70314035-00202-1, zona kadastrale Komoran

1	Elkos Shpk	453,000.44	20	1.0%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
2	NTP Te Luli	45,000.00	10	1.0%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
3	NTP Inter Commerce	130,000.00	40	1.0%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓

Ofertat e pranuarat per parcelen me nr.P-70314035-01979-0, zona kadastrale Komoran

1	Shpk Abi	3,300,000.00	110	1.0%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
2	Ragip Veseli	2,000,000.00	50	1.0%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
3	Valon Ajazi	1,000,000.00	45	1.0%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓

Ofertat e pranuarat per parcelen me nr.P-70314035-01981-0, zona kadastrale Komoran

1	DPT Next Plast	600,000.00	15	1.0%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
2	NTP Inter Commerce	130,000.00	15	1.0%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓

Ofertat e pranuarat per parcelen me nr.P-70310058-02652-2, zona kadastrale Arlat

1	Autoshkolla Albioni	200,000.00	13	0.25%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
2	1p Kos Shpk	3,500,000.00	24	1.0%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
3	Bentla Company Shpk	800,000.00	40	1.5%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓

Ofertat e pranuarat per parcelen me nr.P-70315015-00764-0, zona kadastrale Gillogar

1	Fer Petroll	501,743.00	3	1.0%	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
---	-------------	------------	---	------	---	---	---	---	---	---	---

Komisioni Vlersues, 1. Futura Avdij, 2. Sabrije Kukaj, 3. Sabrije Kukaj, 4. Arben Kulaj



Vjosa Ahmetaj

From: Zahrie Podrimqaku
Sent: 09 November 2020 15:11
To: Shkrimorja Mapl; Vjosa Ahmetaj
Cc: Kimete Sh. Qorri; Ramiz Lladrovci; Labinot Halilaj
Subject: FW: Kërkesë për informata dhe materialë shtesë....
Attachments: DOC053.pdf

Te nderuar/a !

Bashkangjitur e gjeni informatën shtesë të detajuar lidhur me kërkesën tuaj për informatë se në cilën pjesë të PZHK është e rregulluar çështja e Vendimit Nr. 12-400/01-28767.

Me respect Zahria.

From: Flutura F. Avdiu
Sent: Monday, November 9, 2020 2:52 PM
To: Zahrie Podrimqaku
Cc: Ramiz Lladrovci; Labinot Halilaj; Kimete Sh. Qorri
Subject: Re: Kërkesë për informata dhe materialë shtesë....

E nderuar znj. Podrimqaku,

Sipas kërkeses tuaj gjeni te bashkengjitur Informatet e kerkuar nga Ministria e Pushtetit Lokal, si dhe Vendimin e miratimit te Planit Zhvillimor Komunal dhe Konfirmimin e Ligjshmerise te vendimit te kuvendit per miratim nga MPL.

Me nderime,

Flutura Avdiu
Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit
Komuna e Drenasit
[+38349 978 021](tel:+38349978021) | [038 200 40 812](tel:+38320040812)
flutura.f.avdiu@rks-gov.net

From: Zahrie Podrimqaku
Sent: Monday, November 9, 2020 11:08 AM
To: Flutura F. Avdiu
Cc: Kimete Sh. Qorri; Ramiz Lladrovci
Subject: FW: Kërkesë për informata dhe materialë shtesë....

Të nderuar/a

E nderuar drejtoreshë ju lutem në afat sa më të shkurter të bëni të gatshme informata e kërkuar nga MPL të poshtshenuar në email për tju pergjigjur emailit:

Me respekt!

Shefja e Zyrës së Kuvendit

Zahrie Podrimqaku Subashi

Tel; 03820040872

Mob; 049-977 973.

Emaili: Zahrie.podrimqaku@rks-gov.net

From: Vjosa Ahmetaj

Sent: Monday, November 9, 2020 10:47 AM

To: Labinot Halilaj

Cc: Venera Çerkini; Xhevat Tafa; Zahrie Podrimqaku

Subject: Kërkesë për informata dhe materiale shtesë....

I nderuar,

Ju lutem për vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimeve të miratuara në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Glllogocit të datës 30.10.2020 si në vijim:

- Vendim 12 Nr. 462/01-47385 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nënë (99) vite të pronës së paluajtshme të komunës për kompaninë Elkos shpk;
- Vendim 12 Nr. 462/01-47381 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nënë (99) vite të pronës së paluajtshme të komunës për personin fizik Ragip Veseli;
- Vendim 12 Nr. 462/01-47361 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nënë (99) vite të pronës së paluajtshme të komunës për kompaninë IP Kos shpk Glllogoc;
- Vendim 12 Nr. 462/01-47375 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nënë (99) vite të pronës së paluajtshme të komunës për kompaninë IP Kos shpk Arllat;
- Vendim 12 Nr. 462/01-47375 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nënë (99) vite të pronës së paluajtshme të komunës për kompaninë Fer Petrol Glllobar;

na nevojitet Vendimi për miratimin e Planit Zhvillimor të Komunës, si dhe informata se a janë të parapara këto zona sipas Planit Zhvillimor të Komunës.

Me respekt,

Vjosa Ahmetaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit



DATE:	09.11.2020
NUMËR:	08-070/01-48779
PËR/ZA/TO:	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - Prishtinë
PËRMES:	Kryetarit të Komunës së Glllogocit - z. Ramiz Lladrovë
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Glllogocit, Drejtori: Fiutura Avdiu
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë



Të nderuar

Lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve të miratuara në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Glllogocit të datës 30.10.2020 përmes procedurës së shprehjes së interesit:

- Vendimi 12 Nr.462/01-47385 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme të komunës për kompaninë Elkos shpk;
- Vendimi 12 Nr.462/01-47381 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme të komunës për personin fizik Ragip Veseli;
- Vendimi 12 Nr.462/01-47361 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme të komunës për kompaninë IP Kos shpk Glllogoc;
- Vendimi 12 Nr.462/01-47375 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme të komunës për kompaninë IP Kos shpk Arllat;
- Vendimi 12 Nr.462/01-47354 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme të komunës për kompaninë Fer Petrol Glllobar.

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit ka dhënë sqarime bazike, të cilat sqarime i referohen dokumenteve aktuale valide të planifikimit hapësinor përkatësisht, Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028 (i miratuar me vendim të kuvendit komunal 12-Nr 400/01-28767 të datës 30.07.2020).

Për informimin tuaj, duke theksuar se, Planit Zhvillimor Komunal i Glllogocit 2020-2028 (i hartuar sipas Ligjit 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ 08/2017 për normat teknike të Planifikimit Hapësinor) përmban kornizën e zhvillimit hapësinor por nuk përcakton konkretisht kushte

zhvillimore për parcela të raktuara, por përqendrohet në dispozitat e përgjithshme për zbatim, duke mbështetur në:

Kornizën e Zhvillimit Hapësinor (kapitulli 3 – Pzhk 2020-2028)

3.2 – Qëllimet dhe objektivat

3.2.1 – Zhvillimi Ekonomik -

Qëllimi 2 – Nxitja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese (NVM);

Qëllimi 3 – Ngritja e e kualitetit të veprimtarive shërbyese;

Qëllimi 4 – Nxitja e zhvillimit të turizmit rural;

3.2.5 – Vendbanimet

Qëllimit 2 – Fuqizimi i nënqendrave me shërbime

4.1 Prioritetet Strategjike - Zhvillimi Ekonomik respektivisht, Nxitja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese (NVM) është ranguar e dyta në listën prioriteteve e cila është identifikuar arapakisht me palët e interesit duke përfshirë EKP-në dhe EKK-në si dhe në prani të MIA-së gjatë punëtorisë së planit të veprimit dhe prioriteteve.

5.1. Dispozitat për zbatim

Për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e Planit Zhvillimor të Komunës së Glllogocit 2020-2028 përdoren mekanizma që janë të përfshira në kuadër të kapitullit të dispozitave për zbatim. Dispozitat janë të detyrueshme, rrjedhin nga korniza ligjore dhe udhëheqin arritjen e qëllimeve dhe objektivave të PZHK.

Me qëllim të realizimit të PZHK-së, Komuna duhet të hartojë dhe aprovojë Hartën Zonale të Komunës. Përmes Hartës Zonale të Komunës (HZK) këto kushte do të zbërthehen dhe detajohen dhe do të jenë kushte zhvillimore dhe rregulla të ndërtimit për infrastrukturën teknike, publike, sociale, banimit dhe kushtet tjera për zhvillimin dhe mbrojtjen e resurseve natyrore, kulturore, ekonomike dhe të trashëgimisë.

Bazuar në elaborimin e lartëshënuar mbi bazueshmërinë, përputhshmërinë dhe mbulueshmërinë me Planin Zhvillimor Komunal si dhe trajtimin e lokacionit/parcelave aktuale në aspektin e ndërlidhjes konstatohet se të gjitha parcelat hyjnë në Brenda kufirit ndërtimor në të cilën këto zona janë të parapara sipas Planit Zhvillimor Komunal.

Drejtoria për Planifikim Urban dhe mbrojtje të Mjedisit konsideron që aktivitetet e personave fizik dhe juridik (shfrytëzuesve të pronave të paluajtshme të Komunës sipas Vendimit 12-Nr-400/01-28767 – dt. 30.07.2020) nuk bien ndesh me Planin Zhvillimor Komunal të Glllogocit për periudhën 2020-2028.

Me respekt!

Ministria e Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration



Ministria e Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration

Numri: 20-595/14
Data: 19.08.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MEA-së
Nga:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MPL 18.08.2020
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Nr. 020-543/9 1 Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2 Zyrtari përgjegjës për harrimin e shkresës përcjellëse Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendim 12 Nr. 400/04-28767 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, i cili siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeti raportin e vlerësimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit

të ligjshmërisë është siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen e
Lokaleve akteve komunale në vijim:

Vendimi 12. Nr. 400/04-28767 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Glogocit
2020-2028, miratuar nga KK Glogoc.

I miratuar me datë: 30.07.2020

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 03.08.2020

I dërguar për shqyrtim në MEA, me datë: 05.08.2020

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës, me
sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislativonit në
fuqi.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo
sqtarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



12 Nr 400/01-28767 dt. 30.07 2020

Bazuar në nenin 11,12, dhe 40, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 34,pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 10 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 , të Ligjit Nr.04/L-174, për Planifikimin Hapësinor, Vendim Nr.632 për dhënien e Pëlqimit për Miratim të Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028, nga Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, të inicuar dhe hartuar nga Komuna e Glllogocit. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 30. 07.2020, miratoj këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË GLLOGOCIT 2020-2028

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Glllogocit të miratoj propozim vendimin për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit për periudhën 2020-2028.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Zhvillimor Komunal i Glllogocit për periudhën, 2020-2028.

Neni 3

Plani Zhvillimor Komunal i Glllogocit 2020-2028, është hartuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit në koordinim me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit për periudhën 2020-2028, përgjegjëse është Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Glllogocit.

Neni 5

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij propozim vendimi duhet të jetë në gjuhë zyrtare dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15,ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pasë publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Drejtorisë Përkatëse
- Zyrës së Kuvendit
- Arkivit



Kryetari i Kuvendit të Komunës

Edinot Halilaj